



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2550/19 prot.

Datë 05.01.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 05/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.01.2024 mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1179/2023, datë 17.11.2023 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83327-10-11- 2023, me objekt: “LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm CARM me detektor dhe panel të sheshtë.”, me fond limit 25,133,333.33 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

**Autoriteti Kontraktor:** Spitali Universitar i Traumës

*Rr. “Lord Bajron” Laprakë, Tiranë*

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Health & Light” SHPK me NIPT L42231011L *Rruga: “Themistokli Gërmenji”, Nd 11, H.4, Ap.4, Njësia Administrative nr. 2, 1010, Tiranë*  
*Operatori ekonomik*

“BNT Electronics” SHPK me nipt J61817047D

*Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datën 17.11.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1179/2023 ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK dhe “BNT Electronics” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83327-10-11-2023, me objekt: “LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm C-ARM me detektor dhe panel të sheshtë.”, me fond limit 25,133,333.33 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumes.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK dhe “BNT Electronics” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*  
*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2 . Në datën 19.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. Nr. 1320/2023 ku vendosi:

- 1. Të anulojë procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-71980-06-08-2023 me objekt “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83327-10-11-2023, me objekt: “LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm CARM me detektor dhe panel të sheshtë”, me fond limit 25,133,333.33 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës..*
- 2. Autoriteti kontraktor të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik në lidhje me anulimin e procedurës së prokurimit dhe në procedurën që do të rihedhë të mbajë parasysh konstatimet e KPP të shprehura në vendimin nr. 1179/2023 datë 17.11.2023*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ti propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ sipas konstatimeve të mësipërme.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit*

6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.3 Me shkresën nr. 9prot., datë 03.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2550/16 prot., datë 04.01.2024, autoriteti kontraktor Universiteti “Spatiali Universitar i Traumës, njofton se ka zbatuar vendimin nr 1320/2023 datë 19.12.2023 duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83327-10-11-2023, me objekt: “LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm CARM me detektor dhe panel të sheshtë”, me fond limit 25,133,333.33 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

## **II**

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 9 prot., datë 03.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2550/16 prot., datë 04.01.2024, autoriteti kontraktor Universiteti “Spatiali Universitar i Traumës, njofton se ka zbatuar vendimin nr 1320/2023 datë 19.12.2023 duke anuluar procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83327-10-11-2023, me objekt: “LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm CARM me detektor dhe panel të sheshtë”, me fond limit 25,133,333.33 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 13-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, u konstatua se autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit sipas përcaktimeve në vendimin Nr. 1320/2023 datë 19.12.2023.

II.3. Sa më sipër, KPP konstaton se autoriteti kontraktor Spatali Universitar i Traumës,, e ka zbatuar vendimin Nr. 1320/2023 datë 19.12.2023. të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me rishpalljen e procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-83327-10-11-2023, me objekt: “LOT 1 - Blerje Sistem i lëvizshëm CARM me detektor dhe panel të sheshtë”, me

fond limit 25,133,333.33 lekë (pa TVSh), parashikuar për t'u zhvilluar në datë 13-11-2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

2. Në rast rishpallje të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë përcaktimet e vendimit Nr 1179/2023, datë 17.11.2023, dhe të sjellë DST e reja pranë Komisionit Prokurimit Publik.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**

